



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 6201 Prot.

Fier, më 23.05.2025.

PROJEKT VENDIM
Nr. 50, datë 23.05.2025

PËR DHËNIE NDIHME SHTETËRORE FINANCIARE

Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Ervis Tare, lagjia "Konferenca e Pezës", Njësia Administrative nr.2, i dëmtuar nga plasja e bombolës së gazit në banesën e tij në datën 11.05.2025.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga plasja e bombolës së gazit në banesën e tij në datën 11.05.2025, shkresës zyrtare nr.514/1.prot, datë 22.05.2025 "*Vlerësim dëmi*" të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Ervis Tare dëmi në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën 49 500 (*dyzetë e nëntë mijë e pesëqind*) lekë dhe në anën ndërtimore të banesës në vlerën 130 560 (*njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë*) lekë, ndaj bazuar në nenin 30, shkronja "gj", e ligjit 45/2019,

PROPOZON:

1. Dhënie e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasin Ervis Tare, në masën 100%, për dëmet e shkaktuara në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej 49 500 (*dyzetë e nëntë mijë e pesëqind*) lekë.
2. Dhënie e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën 50%, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej 65 280 (*gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë*) lekë, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës "ç" "Përcaktimi i ndihmës financiare" e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Ervis Tare është në masën 114 780 (*njëqind e katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë*) lekë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile
Nasip **BANI**

Drejtoria Juridike
Esmeralda **KAPLLANAJ**

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Pranvera **ÇINA**

KRYETARI
Armando **SUBASHI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR
Vasil **BREGU**

